



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	12.05.2023
REFERENC-Ë:	4683-2/22 - ZSP- 2023
PËR/ZA/TO:	„Gentipharm” sh.p.k. , Rr. Mgj. Pri -Pejë , Park i Biznesit Korroticë e Epërme- K. Glllogoc
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Servet SPAHIU, Zëvëndësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvëndësues i drejtorit të ARPL- së Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim – Leje Ujore

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tekniko-investiv shtesë, me Nr. të protokollit: 4683-2/22, parashtruar nga „Gentipharm” sh.p.k. , Rr. Mgj. Pri -Pejë , Park i Biznesit Korroticë e Epërme - K. Glllogoc dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkresë përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

LU

Datë: 12.05.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ, MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës „Gentipharm ” sh.p.k. , Rr. Mgj. Pri –Pejë , Park i Biznesit Korroticë e Epërme- K. Gllogoc për **Leje Ujore** për shfrytëzimin e ujërave nëntokësor nga Pusi, K. Drenas, fabrikë e barnave, sipas kushteve vijuese:

1. Sasia maksimale për shfrytëzim e ujit nëntokësorë nga pusi është $Q_{max}=1.5$ l/s (një pikë pesë litra për sekond) në parcelen kadastrale nr. 00027/53 ne fl. Poseduese nr. 1049; në Krivovë, K. Drenas, Pusi me koordinata: (X =7 496 879; Y= 4 718 171);
2. Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësit, duhet të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m^3 /ditë), dhe sasinë vjetore (m^3 /vit);
3. Për sasinë e shfrytëzuara pala obligohet që për çdo gjashtë muaj, të informoj me shkrim ARPL/MMPHI, nga momenti i marrjes së lejes ujore;

Faqe 2 nga 4

Adresa: ish Pallati i Mediave, kati 14-17, 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon/Faks: + 381 38 517 638; +381 38 517 558
<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



4. Nr. Serik i ujëmatësit i prezantuar në ARPL/MMPHI, prej pranimit të këtij vendimi, duhet të jetë i njejtë, si dhe për ndërrimin e mundshëm të tijë, duhet informuar Organi përgjegjës, që e ka lëshuar këtë vendim;
5. Obligimi për kompensimin e ujit të shfrytëzuar, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPHI, sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi, për Strukturën e Pagesave të Ujit;
6. Për këtë pala obligohet të raportoj shfrytëzimin, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbi sasinë e shfrytëzuar të ujit të matur përmes Ujëmatësit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;
7. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (Pesë) vite, me mundësi vazhdimi sipas kërkesës së palës;
8. Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që 2 (dy) muaj para skadimit të afatit, të paraqes kërkesë për vazhdimin të lejes ujore;
9. Në rast se pala vendos, lidhur me rritjen apo zvogëlimin e shfrytëzimit, duhet të bëjë kërkesë për ndryshim të lejes ujore;
10. Leja ujore nuk mund të bartet tek personat e tretë, pa informimin e organit kompetent që e ka lëshuar të njëjtën;
11. Me që fabrika ka të bëjë me prodhim teknologjik të prodhimit të barnave, duhet të siguroj Zonat Sanitare të Pusit, për arsye të mbrojtjes së tijë nga efektet e mundëshme të dëmshme për shëndetin publik;
12. Validiteti i Lejes Ujore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të kërkuara më sipër.

ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: Certifikata e regjistrimit të biznesit të "Gentipharm" (810812124); Cetifikata e nr. Fiskal; Certifikata mbi të drejtën e pronës së paluajtshme nr 952/17288, K. Gllgoc; Akvendim mbi ndertimin e objektit, fabrikë për prodhimin e barnave, me Nr. 351-7102, dt 20.07.2011; Leje urbanistike nr. 353-6200, dt. 16.16.2011, vendim për pëlqim mjedisor Nr. 13/278/1-ZSP- 205/13, datë 25.09.2013; Vendim për Lejen Mjedisore të Integruar , me Nr. 18/5177/ZSP/ 21, datë 09.08.2021; Dokumentacionin tekniko investiv i shfrytëzimit të ujërave nga fabrika e barnave në korroticë të Epërme , K. Drenas; kontratat me hartuesin e projektit; Profili i Pusit,; Llogaritja e parametrave hidrogeologjik; Certifikata e biznesit të dëshmi për ixhinierin e diplomuar –Certifikata; Diplome Bach. e hidroinxinierit ; Plani i situacinin tematik, me perpjesë të



lexueshme 1:1000, ashtu siq kërkohet me U.A 03/2018 për procedurat per leje ujore, nënshkruar dhe vulosur nga person i licencuar me nr. licence 228 – Agon ELSHANI; si dhe letërnjoftimi i tijë. CD-ja ;Pagesat për tarifrat gjate aplikimit për K.U.; PU; L.U. Andaj, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, shikimit në vend , me 29.12.2022, akteve administrative të lëshuara nga organet kompetente, legjislacionit për ujërat për shqyrtimin e aplikacioneve për akte ujore, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në inicimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 4683-2/22 - ZSP- 2023, datë: 12.05.2023

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës se Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Gllogoc;
- Arkivit të Ministrisë.

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

